

# KONTRATA SOCIALE KUKËS

## RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

SHTATOR 2022 - SHTATOR 2023

Viti i IV i monitorimit

PËRGATITUR NGA:  
QENDRA PËR PROGRES RINOR



# RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE TË KONTRATËS SOCIALE BASHKIA KUKËS

PROGRAMI: POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Shtator 2022 – Shtator 2023

Qendra për Progres Rinor, Kukës



Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin tek qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve, projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Centre” në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

### Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- “Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile”, Durrës;
- “Qendra Rinore”, Vlorë;
- Qendra “Epoka e Re”, Fier;
- Qendra “Intelektualët e Rinj Shpresë”, Shkodër;
- “Lëvizja Rinore për Demokraci”, Pukë;
- “Qendra Rinore për Progres”, Kukës;
- Qendra “Tjetër Vizion”, Elbasan;
- Qendra “Gruaja në Zhvillim”, Korçë;
- Qendra “Hapa të Lehtë”, Vau i Dejës.

*Ky Raport është Përgatitur nga “Qendra për Progres Rinor”, Kukës në kuadër të projektit POP “Përballja e Ofertave Politike”, “Monitorimi i zbatimit të Kontratës Sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy”. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.*

## Tabela e Përmbajtjes

<b>SHKURTIME .....</b>	<b>5</b>
<b>FALENDERIME .....</b>	<b>6</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>7</b>
<b>METODOLOGJIA .....</b>	<b>10</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>11</b>
<i>Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 6 prioritete e Kontratës Sociale: .....</i>	<i>11</i>
<b>ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE .....</b>	<b>12</b>
<b>PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>15</b>
<b>PËRMBUSHJA E PRIORITETEVE SIPAS VITEVE TË MONITORIMIT .....</b>	<b>16</b>
<b>REFERENCA .....</b>	<b>17</b>
<b>ANKESE .....</b>	<b>18</b>

## Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për pa-aftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID 19	Pandemia e Virisit Korona
Kontrata Sociale <sup>1</sup>	6 prioritetet kryesore të identifikuar nga të rinjtë gjatë 2019
TDH	Terr Des Hommes

<sup>1</sup> Prioritetet e Kontratës Sociale <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-kuces/>

## Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë kësaj periudhe bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë të rinjtë e angazhuar, Drejtorinë e Rinisë dhe të Politikave, si dhe Institucionet dhe Individët/ekspertët, për përgjigjen e shpejtë, cilësore brenda afatit kohor si dhe Këshillin Bashkiak Kukës, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra.

Falenderojmë veçanërisht te rinjtë dhe qytetarët që pranuan ti përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë Olof Palme International Center dhe NED – National Endowment for Democracy për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

## Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec, Kukës dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës shtator 2021-2022 për të tretin vit me rradhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Gjatë periudhës **Shtator 2022 – Shtator 2023**, procesi i lobimit të zbatimit të prioriteteve të kontratës sociale ka vazhduar. Gjatë periudhës Qershor – Tetor 2023 ka patur një ndërprerje e cila është shkaktuar nga situata zgjedhore në Kukës. Gjatë kësaj periudhe ka patur dy herë zgjedhje për kryetar Bashkie; në 14 Maj dhe në 24 Shtator.

### **Ky është viti i katërt i monitorimit të punës së pushtetit vendor për përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve dhe përmbushjen e Kontratës Sociale.**

Kontrata Sociale në Kukës përmban prioritete që qytetarët e Kukësit identifikuan në zgjedhjet lokale duke filluar nga viti 2019. Qendra për Progres Rinor (QPR), synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetarë në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. QPR mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Kukës, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin e Bashkiak përgjegjës për adresimin e tyre, por duke përdorur edhe zgjedhjet parlamentare të 2021, advokoi me të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës Sociale.

Gjatë pranverës së vitit 2023, fushatës vendore, është realizuar procesi i konsultimit për përgatitjen e prioriteve të kontratës sociale e cila ju paraqit kandidatëve për kryetar bashkie. Takimet u realizuan në 8 Maj 2023.

Për shkak të situatës dhe zhvillieve pas zgjedhore, takimet publike të kontratës sociale, me kanidatët, në zgjedhjet e përsëritura u mbajtën me datë 16 Shtator në Kukës.

Në vitin e parë të monitorimit të kontratës sociale për bashkinë Kukës, 40 % e prioritetëve të qytetarëve. Gjatë vitit të dytë të monitorimit për përmbushjen e kontratës sociale, bashkia e Kukësit arriti të adresonte 55%, gjatë vitit të tretë 60% dhe në përfundim të 4-vjecarit, u adresuan 70% e prioritetëve të kësaj kontrate duke i hapur rrugë kështu rivlerësimit nga ana e Bashkisë edhe të prioritetëve të tjera të dala nga takimet periodike mes komunitetit dhe Qendrës për Progres Rinor për vitin 2024.

Raporti<sup>2</sup> i vitit të parë monitorues, raporti<sup>3</sup> i vitit të dytë dhe raporti i tretë<sup>4</sup> monitorues janë ndarë gjerësisht me përfaqësues të bashkisë Kukës si edhe me qytetarët duke analizuar arritjet por edhe punën që duhet bërë për përmbushjen e atyre prioritetëve që janë adresuar pak dhe kanë nevojë për një vëmendje më të shtuar të pushtetit vendor.

Për të mbërritur në vitin e tretë të monitorimit, gjatë vitit 2022, projekti vazhdoi me “Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca”, duke vijuar monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve. Gjithashtu, gjatë periudhës për zgjedhjet vendore u hartua kontrata e re social 2023 – 2027. Priritetet e kontratës janë si më poshtë;

**- Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor**

*Prioriteti 2. Fuqizimi, përfshirja dhe mbështetja e të rinjve*

*Prioriteti 3. Rivitalizimi i qendrës kulturore<sup>5</sup>*

*Prioriteti 4. Krijimi i Hapësirave Rinore*

*Prioriteti 5. Përcaktimi i një fond buxhetor vjetor për start up për bizneset nga të rinjtë.*

*Prioriteti 6. Përcaktimi i një fondi të veçantë për bibliotekën dhe përmirësimi i sallës së leximit*

<sup>2</sup> Raporti I vitit të parë monitorues: <https://popnetwork.al/raporti-nje-vjecar-kontrata-sociale-bashkia-kukes/>

<sup>3</sup> Raporti I vitit të dytë monitorues: [https://popnetwork.al/kukes\\_raporti-monitorues-shtator-2020-shtator-2021-kontrata-sociale/](https://popnetwork.al/kukes_raporti-monitorues-shtator-2020-shtator-2021-kontrata-sociale/)

<sup>4</sup> Raporti I vitit të tretë monitorues: [https://popnetwork.al/kukes\\_raporti-i-trete-monitorues-i-kontrates-sociale-shtator-2021-shtator-2022/](https://popnetwork.al/kukes_raporti-i-trete-monitorues-i-kontrates-sociale-shtator-2021-shtator-2022/)

<sup>5</sup> (Qendra e re NOK – Qendra YES dhe Salla Kreative mbështetur nga TIKA).



*Prioriteti 7. Rikosntruksioni i shkollës së mesme “Bajram Abdiu” Bicaj<sup>6</sup>*

*Prioriteti 8. Përmirësimi ose/dhe ndërtimi i terreneve sportive në shkolla.*

*Prioriteti 9. Përmirësimi i infrastrukturës sportive, mbështetje për sportet tradicionale, palestër për sportin e mundjes.*

*Prioriteti 10. Përmirësimi i infraskstrukturës sportive, mbështetje për sportet (shah, arte marciale, boks sportet e lojerave me dore etj).*

*Prioriteti 11. Shëndeti mendor dhe fizik, kënd lojërash për fëmijë dhe palestër në natyrë.*

Prioritete e mësipërme, të përfshira në kontratën sociale të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë do të jenë në qendër të procesit të lobimit për vitin 2023 – 2027.

***Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023.***

#### **Gjatë vitit të tretë të monitorimit Organizata kishte si qëllim:**

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të lobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies.
- Të përdorë gjetjet e Raportit studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”<sup>7</sup> për angazhimin dhe informimin e qytetarëve
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

---

<sup>6</sup> Tashmë në proces ristrukturimi

<sup>7</sup> Raporti Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” Korrik 2022

<https://popnetëork.al/ëp-content/uploads/2022/07/Raport-Bashkia-Tirane-2022.pdf>

## Metodologjia

Për të realizuar raportin, QPR, anëtare e rrjetit POP u bazua në hapat e mëposhtëm:

- U monitorua puna e Bashkisë Kukës dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023;
- U dërgua një letër-kërkesë me e mail për informacion, drejtuesve të Drejtorive dhe Departamenteve përkatëse, sipas prioriteteve të Kontratës Sociale.
- U organizuan takime me Drejtorine e Rinise dhe KVR mbi ecurinë e punës sa i përket përmbushjes së prioriteteve të kontratës sociale;
- U monitorua në vazhdim puna e Këshillit Bashkiak Kukës.
- U monitoruan vendimet e Këshillit të Bashkisë Kukës.
- U realizuan disa takime me drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Publike për nevojën e ndërhyrjeve infrastrukturore në disa objekte rinore;
- U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të Bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
- U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak mbi masat e marra nga vetë Bashkia, në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target-grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.
- U analizua dhe monitorua buxheti i bashkisë për vitin 2022 – 2023 si dhe shpenzimet respektive bazuar në open-data;
- U monitoruan dhe analizuan vendimet e KB që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale bazuar në punën e rrjetit POP apo edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit: parashikime të mëhershme në buxhet, plane afatshkurtra apo/dhe afatgjata, puna e organizatave të tjera të cilat mund të kenë ndikuar në përmbushje (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare).
- Analizimi i monitorimit të mediave audiovizive dhe on line, në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.
- U realizuan takime me partnertë të rëndësishëm, vizita në terren dhe verifikim të infrastrukturës rinore.

## Përmbledhje Ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Kukës, të kryer nga Qendra “Qendra për Progres Rinor” më poshtë disa nga gjetjet.

### *Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 6 prioritete e Kontratës Sociale:*

- Gjatë periudhës Shtator 2022 – Shtator 2023 është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme Vendimmarja e Këshillit të Bashkisë;
- Bashkia Kukës me drejtoritë e saj është partnere e qëndrueshme dhe palë e interesuar në adresim dhe realizim të kontratës sociale;
- Këshilli përbëhej nga 22 Burra dhe 8 gra ose 27% gra. Ka patur disa ndryshime të këshilltarëve për arsye të ndryshme;
- Këshilli i ri i bashkisë Kukës (2023 – 2027) përbëhet nga 21 burra dhe 9 gra.
- Këshilli ka marrë në shqyrtim dy peticione të inciuara nga QPR iniciativave komunitare;
- Prioritetet e Kontratës Sociale janë relevante dhe në përputhje me nevojat e komunitetit të rinjve dhe komunitetit në tërësi;
- Realizimi i prioriteteve është i mundshëm, i i vlefshëm dhe i rëndësishëm si për qeverisjen vendore ashtu edhe për qytetarët;
- Lobimi për adresim dhe realizim të prioriteteve të kontratës sociale gjatë periudhës së zgjedhjeve vendore ishte i sukseshëm. Në 8 Maj u realizuan dy forumet publike me kandidatë për kryetara bashkie. Duke qenë se në Shtator pati zgjedhje pr krytar bashkie në Kukës përsëri, u realizuan forumet me kandidatë ku u firmosën edhe kontratat sociale respektive, me 16 Shtator 2023.

## Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale

### PRIORITET NR. 1:

Përshtatje e ambjenteve ekzistuese, pronë e Bashkisë për Qendër Rinore multifunkionale brenda vitit 2022; Manaxhim i saj nga vetë Bashkia ose të jepet në përdorim ambjenti tek Organizata që janë në gjendje ta menaxhojnë dhe ofrojnë si shërbim;

Gjatë kësaj periudhe përveç **QPR Kukës** ka edhe aktorë të tjerë të mundshëm të cilën janë përpjekur të ofrojnë shërbime për të rinjtë pa një qendër të mirfilltë rinore. QPR vazhdon ofrimi e shërbimeve me karakter rinor, edukim jo formal, trajnim, shkëmbim eksperimentesh në nivle kombëtar e ndërkombëtar.

**American Corner** është një tjetër hapsirë me shumë vlerë në Kukës. Me hapsirën cilësore, fondin e mjeteve dhe librave në gjuhë të huaj në dispozicion, në partneritet edhe me QPR Kukës, American Corner Tiranë dhe Vlore, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane kanë sjellë mbështetje për të rinjtë.

**Terre des Hommes**<sup>8</sup> me programet e saj ka targetuar kryesisht të rinj të rikthyer nga emigracioni dhe të rinj nga familje në nevojë. Shërbimet e ofruara shkojnë drejt këshillimit të karrierës, këshillim psikologjik e social, mbështetje për iniciativa rinore dhe aftësim për jetën.

Perspektiva të reja është programi i rëndësishëm në Kukës. Me burimet në dispozicion, programi është një vlerë e shtuar dhe e rëndësishme në përbushje të prioriteve rinore. Programi do të vazhdojë deri në Shtator të vitit 2026.

**NOK – Qendra NOK** e riparuar në kapacitetin e qendres për ofrim të kurseve dhe trajnimeve të ndryshme, është tashmë funksionale.

Këto shërbime të ofruara nga partner të rëndësishëm dhe të ndryshëm do të koordinoheshin mjaft mirë nëse do të kishte një hapsirë të mirfilltë rinorë me funksion të dedikuar si Qendër Rinore.

**Drejtoria e Rinisë dhe Projekteve** si me iniciativë ashtu edhe në partneritet me organizata të ndryshme ka realizuar një seri aktivitesh në mbështetje të kauzave rinore;

**Rural You** është një tjetër program që targeton të rinjtë në Kukës me fokus në zonat rurale dhe planifikon ngritje të kapaciteteve dhe rritje të përfqësimit në qeverisje. 7 të rinj, me ide biznesi janë

---

<sup>8</sup> Aneks 2 aktivitetet e realizuara

mbështetur me trajnim, rritje të aftësive të buta si dhe me materiale për zhvillimi e ideve të tyre të bizneseve (Bletari, Digital Marketing, Guidë Turistike, Sporte ujore dhe perpunim të bimëve te egra)<sup>9</sup>

### **PRIORITET NR. 2:**

Ndërhyrje në sistemin sanitar në Shkollat: Vlerësim të gjendjes në të gjitha shkollat.

Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar ndërhyrje rutinë në objekte shkollore me qëllim mirëmbajtje.

Shërbimet publike kanë vijuar mirëmbajtjen rutinë më lysterje, ndërhyrje të vogla dhe emergjente. Nevoja për kushte higjienike të shtuara ka nxjerr në pah emergjencen në të cilën sistemet sanitare ndodhen, mungesën e furnizimit me ujë dhe pamundësinë e funksionimit në kushte të pranueshme.

### **PRIORITET NR. 3:**

Përcaktim në buxhet të zërit të dedikuar për financim me 20% të programeve Start Up me partnerët aktual GIZ – IDEA, UNDP dhe Partners Shqipëri apo organizatave të tjera të angazhuara në këtë fushë. Përcaktimi i një fondi prej 700,000 ALL për vitin buxhetor.

Ky prioritet nuk është realizuar. QPR ka mbështetur të 7 të rinj; Rural You dhe RTM kanë mbështetur 2 iniciativa në Kukës si dhe Perspektiva të Reja kanë filluar procesin e identifikimit të të rinjve me ide të cilat mund të mbështeten financiarisht.

### **PRIORITET NR. 4:**

Ndikim në këshillim të karrierës në të gjitha shkollat e mesme brenda territorit të bashkisë Kukës dhe organizim të dy Panairove të Mundësive nga vetë Bashkia ose kontraktim nga ofrues më eksperincë. Përcaktim të kuotës prej 30 të rinj për ofrim të trajnimit profesional në Kukës, Prizren apo Tiranë dhe financim i kostove të transportit.

Gjatë kësaj periudhe me mbështetjen e GIZ dhe Ambasadës Britanike TdH po ofron në këshillim karriere për të rinjtë një Kukës. Gjithashtu, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane dhe me European Youth Foundation, QPR ka zbatuar projektin në mbështetje të zhvillimit të ideve dhe

---

<sup>9</sup> Programi është mbyllur në Shtator 2023 dhe është zbatuar nga Qendra për Progres Rinor në Kukës

iniciativave të sipërmarrjes nga të rinj, kryesisht të rikthyer nga emigracioni dhe të papunë si dhe ka ofruar këshillim karriere në 6 komunitete shkollore të zonë rurale.

Perspektiva të Reja ka kontratuar disa organizata për të ofruar shërbim të këshillit si në karrierë apo zhvillimi të iniciativave të biznesit.

### **PRIORITET NR. 5:**

Punësim sezonal prej 2 muajsh pranë Institucionit të Bashkisë Kukës dhe Drejtorive në varësi të 20 të rinjve student të viteve të fundit Bachelor dhe Master në profilet e tyre të studimit.

Me initiative dhe në mbështetje të kërkesës së Drejtorisë së Rinisë, Bashkia Kukës kishte planifikuar zbatimin e prioritetit të mësipër<sup>10</sup>. Për shkak të pandemisë dhe fushatës zgjedhore të vitit 2023 nuk ishte e mundur zbatimi i tij. Në bashkpunim me Drejtorinë e Rinisë do të llobohet që për vitin tjetër në bazë edhe të kushteve dhe situatës të zbatohet si prioritet.

### **PRIORITET NR. 6:**

Përcaktimi i një fondi specifik në Buxhetin e vitit 2021 - 2022 prej 1,600,000 ALL për mbështetje të aktiviteteve rinore; Përcaktim i modaliteteve të konkurimit dhe gjithpërfshirje të grupeve rinore në të gjitha njësitë administrative.

Prioriteti i mësipërm mbetet sfidë. Bashkia e Kukësit me mbështjeten e QPR është fituese e programit ReLoad. Reload ka realizuar fazën e pare dhe ka kontraktuar fazën e dytë të zbatimit të tij. Në fazën e tretë të thirjes fokus të vecantë do ti lihet rinisë dhe do t'i dedikohet të rinjve. Këshillit Rinor Vendor do ti kontribuojë lobimit më të fortë për realizim të aktiviteteve Rinore. Këshilli Rinor do të zgjedhë anëtarët e rinj bazuar në ligj. Procesi do të mbështetet nga QPR dhe do të udhëhiqet nga Drejtoria e Rinisë.

---

<sup>10</sup> <https://kukes.gov.al/programi-kombetare-i-praktikave-te-punes/>


## Përfundim dhe Rekomandime

- ❖ Prioritete e Kontratës Sociale janë relevante, të arsyeshme dhe pjesë e prioriteteve të fushë së rinisë;
- ❖ Prioritetet janë zbatuar pjesërisht dhe mbetet shumë punë për të bërë deri në realizimin e tyre;
- ❖ Fokusi i shtuar i aktorëve të ndryshëm në fushën e rinisë është mundësi e mirë për të realizuar prioritetet dhe për të adresuar çështjet rinore;
- ❖ Partneritet me Këshillin e Bashkisë dhe Drejtorinë e Rinisë, në zbatim edhe të Rregulloreve të reja të këshillit, ngritja e Këshillit Rinor Vendor si partneriteti i formalizuar me Bashkinë Kukës me anë të memove, i ndihmon realizimit dhe prioriteve të kontratë sociale;
- ❖ Lobimi në nivel qendror, me të zgjedhur në parlament mbetet i rëndësishëm për ngritje ne çështjeve në nivel kombëtar;

## Përmbushja e Prioriteteve sipas viteve të monitorimit

# KONTRATA SOCIALE POP KUKËS 2019-2023

### PËRMBUSHJA E PRIORITETEVE





## Referenca

- Ligji 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”
- Rregulloret e Funksionimi të Këshillit të Bashkisë
- Kontrata Sociale, prioritetet
- Vendim për ngritjen e Këshillit Rinor Vendor

<https://kukesi.gov.al/keshilli-bashkiak/>

<https://www.vendime.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak-kukes/>

<https://popnetëork.al/category/aktivitete-kukes/>

<http://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/>

## Ankese

### Aneks 1

#### Prioritetet e kontratës Sociale 2023 – 2027

#### **Prioriteti 1. Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor**

- Krijimi i një strategjie të re në shpërndarjen e informacionit, kryesisht për ato që lidhen ngushtësisht me interesat e qytetarëve dhe në ndikimin e jetës së tyre (si: programet e ndryshme të nxitjes së punësimit, biznesit, strehimit etj).
- Faqja egzistuese e internetit të jetë lehtësisht e aksesueshme dhe e azhurnuar me të gjitha informacionet e nevojshme që nuk kanë nevojë për kërkesë.
- Fuqizimi i Këshillit Vendor i Rinisë, i ngritur në Bashkinë Kukës, në bazë të ligjit dhe miratuar me vendim të këshillit bashkiak. Të realizohen sipas rregullores takimet periodike me Kryetarin e Bashkisë dhe të ketë deklarata publike nga Këshilli Vendor Rinor dhe Bashkia për rekomandimet/ndikimet në politikat vendore për të rinjtë.

#### **Prioriteti 2. Fuqizimi, përfshirja dhe mbështetja e të rinjve**

- Praktika profesionale për të rinjtë e sapodiplomuar pranë institucioneve shtetërore
- Programe punësimi për të rinjtë me kohë të pjeshme të ofruara në bashki apo institucionet e varësisë
- Transport publik falas – kompensim transporti - për të rinjtë dhe fëmijët e zonave rurale që ndjekin kurse dhe sporte të cilat zhvillohen vetëm në qytet.

#### **Prioriteti 3. Rivitalizimi i qendrës kulturore**

- Pajisja me një studio provash dhe inçizimesh për muzikë për aktivitetet e të rinjve pranë Qendrës Kulturore Kulturore të fëmijëve. Krijimi i Kushteve të përshtatshme si për talente të reja ashtu edhe për profesionistët dhe punonjësit e Qendrës. Paisjet e nevojshme për regjistrim, monitor, audio, kompjuter, mikrofon, kufje etj, të cilat do të administrohet nga Qendra Kulturore e Femijeve, Bashkia Kukës.

#### **Prioriteti 4. Krijimi i Hapësirave Rinore ( Qendra e re NOK).**

- Prioritizimi i ngritjes së një qendre rinore multifunktionale, ku të rinjtë mund të shpenzojnë kohën e lirë në mënyrë produktive, të argëtohen të nxisin dhe ushtrojnë talentet e tyre dhe të iniciojnë angazhimin qytetar.

#### **Prioriteti 5. Përcaktimi i një fond buxhetor vjetor për start up për bizneset nga të rinjtë.**

- Buxhet i veçantë i specifikuar posaçërisht për start-up, ku të rinjtë kanë mundësi për të aplikuar dhe për të zhvilluar një ide biznesi në të ardhmen.

#### **Prioriteti 6. Përcaktimi i një fondi të veçantë për bibliotekën dhe përmirësimi i sallës së leximit**

- Rinovimi i sallës së bibliotekës ( karrige, tavolina, rafte për librat)
- Furnizimi me libra të rinj
- Kënd specifik për lexim
- Sistem ngrohjeje

#### **Prioriteti 7. Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Bajram Abdiu” Bicaj**

- Ndërhyrje prioritare për rikonstruksionin e shkollës me kushtet e nevojshme për procesin mësimor.

Pasjija me laboratorë, sistem ngrohje, ujë të rrjedhshëm si edhe rehabilitimi i hapësirave sportive.

#### **Prioriteti 8. Përmirësimi ose/dhe ndërtimi i terreneve sportive në shkolla.**

- Shkolla “ Bajram Abdiu” Bicaj
- Shkolla ‘Imer Mata’ Zapod
- Shkolla ‘9 Shtatori’ Topojan
- Shkolla “ Elmaz Ademi” Bardhoc
- Shkolla “ Ahmet Voka” Gostil

#### **Prioriteti 9. Përmirësimi i infrastrukturës sportive, mbështetje për sportet tradicionale, palestër për sportin e mundjes.**

- Sporti i mundjes është një disiplinë e njohur në Kukës. Të rinjtë dhe trajnerët e tyre meritojnë mbështetje për pasionin, interesin dhe sukseset e tyre. Ngritja e një palestere të re dhe përmirësimi i kushteve do të ndihmojë në angazhimin e rinjve dhe rritjen e tyre.

### **Prioriteti 10. Përmirësimi i infrasktrukturës sportive, mbështetje për sportet (shah, arte marciale, boks sportet e lojërave me dore etj).**

- Mbështetja e Klubit të Shahut në Kukës duhet të jetë prioritet, duke përfshirë logjistikën, materiale dhe financat për aktivitetet lokale dhe kombëtare.
- Sportet e arteve marciale duhet të mbështeten për të rritur numrin dhe cilësinë e praktikuesve në Kukës.
- Klubi shumësportësh duhet të fuqizohet për të ndihmuar në diversifikimin e sporteve dhe rritjen e numrit të të rinjve dhe praktikuesve të sportit në Kukës, duke ofruar hapësira dhe mbështetje financiare.

### **Prioriteti 11. Shëndeti mendor dhe fizik, kënd lojërash për fëmijë dhe palestër në natyrë.**

- Kukësi ka nevojë për kënde lojërash publik për fëmijë, si një mungesë e kahershme krahasuar me qytete të tjera.
- Një palestër në natyrë për të gjitha grupmoshat do të ishte një shërbim i nevojshëm për qytetarët e Kukësit.